

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"JKL"**

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia.

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit.

Sot më datën 17.09.2024, ne themeluesit kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "JKL"

1) Themeluesit e shoqërisë janë:


- **Znj. ZHIHUI WANG**, lindur më 04.10.1964, në Kine, shtetase e St. Kittis dhe Nevis, mbajtëse e pasaportes se St. Kittis dhe Nevis me numer RE0167577, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,
- **Z. LIXING YANG**, lindur më 11.08.1963, në Kine, shtetas i St. Kittis dhe Nevis, mbajtës i pasaportes se St. Kittis dhe Nevis me numer RE0167575, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,
- **Znj. ZIQI YANG**, lindur më 30.08.1991, në Kine, shtetase e St. Kittis dhe Nevis, mbajtëse e pasaportes se St. Kittis dhe Nevis me numer RE0167576, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,
- **Z. BESMIR LEÇI**, lindur më 04.07.1985, në Kukës, Shqipëri,, shtetas shqiptar, mbajtës i kartes se identitetit me numer 036215865 dhe numer personal I50704089V, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,

Neni 2

Objekti

2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- a) Projektim dhe ndertimi i objekteve civile apo industrial dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kesaj natyre per vete dhe per te trete; b. Investimin në projekte



zhvillimi zonash urabane, turistike apo rezidenciale apo investime të cilësdo natyre qoftë në zhvillimin e pasurive të paluajtshme në përgjithësi; c. Shitja e pasurive të paluajtshme, të njësisve të gjeneruara nga investimet në projekte të zhvillimit të pasurive të paluajtshme, si dhe dhënia me qira e tyre. d. Administrimi dhe shfrytëzimi i njësisve të gjeneruara nga investimet në projekte të zhvillimit në zonat e turizmit apo rezidenciale për qëllime rekreative, restorative dhe akomoduese;

2.2 Shoqëria do të kryejë cdo lloje veprimtarie të dobishme për arritjen e objektivave të saj, duke përfshirë veprimtari për shit-blerje sendesh të luajtshme dhe të paluajtshme, pjesëmarrje në kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarje të tjera. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë cdo lloj veprimtarim apo trasaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprime tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të çfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë **pa afat**.

Neni 4 Selia

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën : *Rruga "Siri Kodra", pallati 100/2, hyrja 3, apartamenti 7, Njesia Bashkiake nr 8, Tirane.*

4.2 Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi si dhe agjensi në adresa të tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.

KREU II Kapitali

Neni 5 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 000 Lek (Njëqind mijë).

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- 1- Znj. ZHIHUI WANG - zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej 25 000 (njëzet e pesë mijë) leke të reja që përben 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë.



- 2- Z. LIXING YANG - zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme prej 25 000 (njezet e pese mije) leke te reja qe perben 25% te kapitalit themeltare te shoqerise.
- 3- Znj. ZIQI YANG- zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme prej 25 000 (njezet e pese mije) leke te reja qe perben 25% te kapitalit themeltare te shoqerise.
- 4- Z. BESMIR LECL- zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme prej 25 000 (njezet e pese mije) leke te reja qe perben 25% te kapitalit themeltare te shoqerise.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit.

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto contribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë ortakun për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të asamblesë së ortakëve, i cili meret në të njëjtat kushte si për ndryshimin e statutit.

Në cdo rast zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund

të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ne statut kushtëzohen kalimi i kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

Organet Vendimmarrëse dhe Drejtuese

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e Thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme e ortakëve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkres ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë vëndin, datën, orën e mbledhjes, si dhe rendin e ditës si dhe t'u dërgohet ortakëve jo më vonë se 7 para ditës

së mbledhjes.

Kur asambleja është mbledhur jo sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për marrjen e vendimeve, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10 Kourumi

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, miratimin e bilancit, kontrollin e llogarive, miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë, riorganizimin, bashkimin ose ndarjen e shoqërisë, shnderimin në një formë tjetër, transferimin e kuotave, emerimin e eksperteve dhe likuidatoreve dhe prishjen e shoqërisë, zhvillon mbledhje të jashtëzakonshme, të cilat janë të vlefshme, kur në të janë pranishëm ortakët me të drejtë vote që zoterojnë me shumicë të gjysmës së numrit total të kuotave të kapitalit të shoqërisë të cilët votojnë me shumicë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji 9901 datë 14.04.2008 dhe merren vendime të vlefshme me votimin pro të $\frac{3}{4}$ të ortakëve pjesëmarrës.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, kur në të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote të cilët zotërojnë më shumë se 40 për qind të kuotave për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

Neni 11 Perjashtimi i Ortakut.

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.



Neni 12
Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga 1 (nje) administrator, i cili do te kete dhe tagrin e perfaqesimit ligjor te shoqërise.
Administrator i shoqërisë është:

1. Z. BESMIR LECI -
- Speciment i nënshkrimit:



Administratori do të ushtrojë detyrën e tij sipas statutit dhe ligjit për një periudhe 5 vjecare me të drejtë ripërtëritje.
Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.
Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.
Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
Administrator i shoqërise mund të emerohet edhe një person jashtë ortakërisë.

Neni 13
Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;



e) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e ortakeve vetem edhe ne rastet kur :

- 1- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojn ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- 2- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojn në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i

administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 14

Përgjegjësite e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose

solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në

interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV Viti financiar-ekspertet



Neni 15
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 16
Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqërise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

KREU V
Prishja – riorganizimi i shoqërisë

Neni 17
Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper ”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e



aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 19

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këto statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këto statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKET E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "JKL"

Znj. ZHIHUI WANG *Zhihui Wang*

Z. LIXING YANG *Lixing Yang*

Znj. ZIQI YANG *Ziqi Yang*

Z. BESMIR LECI *Besmir Leci*